

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092

Ankesë kundër: KOMUNËS SË PODUJEVËS

Numri i Prokurimit: 615-26-5590-5-5-8

Sa i përket tenderit për: "Furnizim me inventar (mobilje)"

ANKESË

1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

"IBM" SH.P.K

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rruga e Ulqinit PN

(Adresa)

Mitrovice

(Vendi)

044/746-641

(Numri Telefonit)

40.000

(Kodi postar)

/

(Numri i Faks-it)

Ermal Bajraktari

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

shpkibmoffice@gmail.com

(Adresa elektronike)



24.08.2026

(Data e parashtrimt të kërkesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtroj kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

/

Shëno të dhënat si në vijim:

/

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të kërkesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Ftesë për ofertim 09.07.2026 15:06
B12 Proces verbali i hapjes së Tenderëve 16.07.2026 09:28
B58 Njoftim mbi vendimin e autoriteti kontraktues 06.08.2026 15:21
Kërkesë për rishqyrtim 11.08.2026 14:21
Vendim për pezullim.pdf 12.08.2026 10:08

Vendimi i AK në Kërkesën për rishqyrtim 14.08.2026 09:41

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

Procesverbalin e hapjes së ofertave e kemi pranuar në e-prokurim

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒

Jo ☐

Letren standarde për tenderuesin e eliminuar e kemi pranuar së bashku me njoftimin mbi vendimin e autoritetit kontraktues në e-prokurim.

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Konsiderojmë se gjatë ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të ofertave, Autoriteti Kontraktues/Komisioni Vlerësues nuk ka vepruar në përputhje me kërkesat e Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar, dhe dispozitat përkatëse të Udhëzimit Operativ për Prokurimin Publik, në veçanti:

Neni 1 i LPP-së – Qëllimi

Neni 6 i LPP-së – Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

Neni 7 i LPP-së – Barazia në Trajtim / Jo-Diskriminimi

Neni 54 i LPP-së – Njoftimi i Kandidatëve dhe Tenderuesve të Eliminuar

Neni 55 i LPP-së – Mënyrat e Komunikimit

Neni 59 i LPP-së – Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

si dhe dispozitat relevante të:

Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, të plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren Nr. 002/2024, përkatësisht:

Neni 17.12 – Dosja e Tenderit

Neni 19.4 – Specifikimet Teknike

Neni 37 – Mostrat e Tenderëve

Neni 40.1 dhe 40.2 – Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

Neni 42.3 – Njoftimi i Tenderuesve/Kandidatëve

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuara për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

7. Deklaratë e detajuar mbi faktet dhe argumentet

AK/Komisioni Vlerësues gjatë ekzaminimit dhe vlerësimit të ofertave për aktivitetin e prokurimit në fjalë nuk ka vepruar në harmoni të plotë me LPP-në dhe legjislacionin sekondar në fuqi.

IBM SH.P.K. është eliminuar për shkak të mosdorëzimit të mostrave, edhe pse nga dokumentacioni i tenderit nuk rezulton një kërkesë konkrete, e veçantë dhe operative që përcakton se operatorët ekonomikë duhet t'i dorëzojnë fizikisht mostrat, cilat produkte

duhet të dorëzohen, ku duhet të dorëzohen dhe sipas cilës procedurë.

Në vijim paraqesim pretendimet tona ankimore dhe kundërshtimet ndaj Vendimit të Autoritetit Kontraktues të datës 14.08.2026.

7.1. Arsyeja e vetme e eliminimit të IBM SH.P.K. ka qenë mosdorëzimi i mostrave

Në B58 dhe në letrën standarde të eliminimit të datës 06.08.2026, AK ka dhënë vetëm këtë arsyetim:

“IBM SH.P.K. Nuk ka dorëzuar mostrat e cekura në specifikacion. Si rrjedhojë shpallet i papërgjegjshëm.”

Asnjë arsye tjetër nuk i është komunikuar IBM SH.P.K. si bazë për eliminimin e ofertës.

Sipas Nenit 54 të LPP-së, kur një tenderues eliminohet për shkak të parregullsisë apo papërshtatshmërisë së tenderit, njoftimi duhet të saktësojë mangësitë e tenderit.

Po ashtu, sipas Nenit 42.3 të Rregullores, Formulari B58 duhet të përmbajë vendimin dhe letrat standarde përkatëse me arsyetimet e nevojshme.

Prandaj, ligjshmëria e eliminimit tonë duhet të vlerësohet mbi bazën e arsyes që na është komunikuar në vendimin fillestar.

7.2. Fjala “mostrat” në Nenin II.3 nuk përbën kërkesë konkrete për dorëzim fizik të mostrave

IBM SH.P.K. nuk pretendon se fjala **“mostrat”** nuk figuron fare në FPO.

Në Nenin II.3 – Specifikimet Teknike është përdorur ky formulim:

“[Furnizimet] [Punët riparuese] [Shërbimet] duhet të jenë plotësisht në pajtim me specifikimet teknike të parashtruara në FPO (shih ANEKSIN 1) dhe në përputhshmëri në të gjitha aspektet me vizatimet, sasitë, modelet, mostrat, matjet dhe udhëzimet tjera.”

Më pas thuhet se mospërputhshmëria me ndonjë specifikim mund të çojë në diskualifikim.

Këtë formulim AK po e interpreton sikur ai krijon detyrim për operatorët ekonomikë që të dorëzojnë fizikisht mostra.

Ne e kundërshtojmë këtë interpretim.

Formulimi i Nenit II.3 është një formulim i përgjithshëm lidhur me **përputhshmërinë teknike të furnizimeve** me specifikimet, vizatimet, sasitë, modelet, mostrat, matjet dhe udhëzimet tjera.

Ai nuk thotë:

“OE duhet të dorëzojë mostra.”

Nuk thotë:

- cilat mostra duhet të dorëzohen;
- për cilat pozicione;
- sa mostra duhet të dorëzohen;
- kur duhet të dorëzohen;
- ku duhet të dorëzohen;
- kujt duhet t'i dorëzohen;
- apo mënyrën e pranimit të tyre.

Në tërë FPO-në e publikuar, termi **“mostrat” paraqitet vetëm në këtë formulim**, ndërsa nuk gjendet formulim **“dorëzojë mostrat”** apo **“dorëzoj mostrat”**.

Kjo dallon dukshëm nga kërkesat tjera në Aneksin 1, ku AK ka përdorur shprehimisht formulimin **“OE duhet të dorëzoj”**, për shembull lidhur me certifikatat apo atestet.

Prandaj, përdorimi i vetëm i fjalës **“mostrat”** në një formulim të përgjithshëm për përputhshmërinë teknike nuk mund, sipas vlerësimit tonë, të zëvendësojë një kërkesë të qartë për **dorëzimin fizik të mostrave si kusht eliminues të ofertës**.

7.3. Pretendimi i AK-së se për “pozicionet përkatëse” është kërkuar dorëzimi i mostrave duhet të provohet me Dosjen e Tenderit

Në Vendimin e datës 14.08.2026, AK deklaroi se kërkesa për dorëzimin e mostrave ka qenë e përcaktuar qartë në Specifikimet Teknike dhe se operatorëve ekonomikë u është bërë e ditur që për **“pozicionet përkatëse”** duhet të paraqiten mostra.

Kërkojmë që OSHP dhe Eksperti Shqyrtues ta verifikojnë këtë konstatim drejtpërdrejt në Dosjen e Tenderit.

AK duhet të tregojë konkretisht:

Në cilën faqe të Dosjes së Tenderit shkruan se duhet të dorëzohen mostra?

Në cilin paragraf?

Për cilat pozicione?

Me çfarë formulimi konkret është vendosur obligimi?

Ku shkruan se mosdorëzimi fizik i tyre e bën tenderin të papërgjegjshëm?

Një deklaram i përgjithshëm në Vendimin mbi Kërkesën për Rishqyrtim se kërkesa ka ekzistuar nuk mund ta zëvendësojë tekstin konkret të Dosjes së Tenderit.

7.4. Rregullorja mbi mostrat zbatohet “kur kërkohen mostrat” dhe nuk e

krijon vetvetiu kërkesën

AK në Vendimin e datës 14.08.2026 është thirrur në Nenin 38 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ lidhur me mostrat.

Sipas Rregullores aktuale të Prokurimit Publik, **Neni 37 titullohet “Mostrat e Tenderëve”, ndërsa Neni 38 titullohet “Sqarimi i Tenderëve”.**

Neni 37.2 përcakton:

“Kur kërkohen mostrat...”

dhe pastaj rregullon afatin e dorëzimit të tyre, duke paraparë që ato duhet të dorëzohen para afatit të fundit të tenderëve.

Pikërisht formulimi **“Kur kërkohen mostrat”** është i rëndësishëm.

Para se të diskutohet afati i dorëzimit të mostrave, duhet të vërtetohet çështja paraprake:

Ku janë kërkuar mostrat në këtë aktivitet konkret të prokurimit?

Nëse Dosja e Tenderit nuk përcakton se cilat mostra kërkohen, Neni 37 nuk mund ta krijojë vetvetiu listën e produkteve që OE duhej t'i sillte.

Neni 37.1 madje përcakton si parim që dokumentet e tenderit në përgjithësi duhet ta shmanjin kërkesën për paraqitjen e mostrave, ndërsa kur ato kërkohen, zbatohet procedura e përcaktuar në këtë nen.

7.5. AK kishte detyrim që kërkesën për mostra ta përcaktonte qartë në Dosjen e Tenderit

Neni 17.12 i Rregullores përcakton se në Dosjen e Tenderit AK duhet të deklarojë **të gjitha informatat relevante** që operatorët ekonomikë duhet t'i dinë për përgatitjen e tenderëve, duke përfshirë specifikimet, kërkesat, kriteret dhe afatet kohore. Dosja duhet të përgatitet në mënyrë që, si rregull, të mos ketë nevojë për informata sqaruese shtesë.

Neni 19.4 kërkon që specifikimet teknike të jenë **të qarta, të sakta dhe precize** dhe të mos krijojnë paqartësi.

Nëse dorëzimi fizik i mostrave do të ishte një kusht aq i rëndësishëm sa mosdorëzimi i tyre të rezultonte me eliminim të menjëhershëm, atëherë ishte përgjegjësi e AK-së që këtë ta përcaktonte qartë dhe konkretisht.

Nuk është e mjaftueshme që pas hapjes dhe vlerësimit të ofertave, një term i përgjithshëm në Nenin II.3 të interpretohet si obligim procedural eliminues.

7.6. Dosja e Tenderit përcakton saktë vendin dhe kohën kur kërkohet një veprim procedural, por këtë nuk e bën për mostrat

Në FPO, AK ka përcaktuar në mënyrë precize:

Data: 15.07.2026

Koha: 14:00:00

Vendi: Platforma elektronike

për dorëzimin e tenderëve.

Po ashtu, për hapjen e tenderëve është përcaktuar data, ora dhe vendi, përkatësisht zyra e prokurimit.

Kjo dëshmon se kur AK vendos një obligim procedural që duhet të kryhet nga operatorët ekonomikë, dokumentacioni përcakton elementet e nevojshme për realizimin e tij.

Ndërsa për mostrat nuk është përcaktuar:

Vendi i dorëzimit.

Adresa.

Zyra.

Personi përgjegjës për pranimin.

Lista e pozicioneve që duhet të dorëzohen.

Kjo çon drejtpërdrejt te pyetja kryesore e kësaj ankese:

Nëse operatori fitues i ka dorëzuar mostrat, si e ka ditur se ku duhet t'i dorëzojë?

7.7. Pretendimi i AK-së se IBM SH.P.K. duhej të kërkonte sqarime nuk e zëvendëson detyrimin e AK-së për të përgatitur Dosjen e Tenderit në mënyrë të qartë

AK në Vendimin e datës 14.08.2026 arsyeton se, nëse IBM SH.P.K. e ka konsideruar dokumentacionin të paqartë, është dashur të kërkojë sqarim para ofertimit.

Ky arsyetim nuk i përgjigjet pretendimit tonë.

IBM SH.P.K. nuk po thotë se ka ekzistuar një kërkesë e qartë për mostra dhe ne nuk kemi qenë të sigurt si ta përmbushim atë.

Pretendimi ynë është se **nuk ekziston një kërkesë konkrete që thotë se OE duhet të dorëzojë fizikisht mostra.**

Operatori ekonomik nuk mund të kërkojë sqarim për çdo kusht të mundshëm që AK mund

ta ketë pasur në mendje, por nuk e ka shprehur si kërkesë.

Neni 17.12 e vendos përgjegjësinë fillestare mbi AK-në që Dosja e Tenderit të përmbajë të gjitha kërkesat dhe afatet relevante.

Prandaj, mosparaqitja e kërkesës për sqarim nuk mund ta shndërrojë pas hapjes së ofertave një kërkesë të papërcaktuar në një kusht eliminues.

7.8. Tenderët duhet të vlerësohen vetëm sipas kërkesave të përcaktuara paraprakisht

Neni 40.2 i Rregullores përcakton se tenderët duhet të ekzaminohen, vlerësohen dhe krahasohen sipas procedurave dhe kritereve të përcaktuara në Njoftimin për Kontratë dhe Dosjen e Tenderit.

Gjithashtu, AK nuk mund të ndryshojë, modifikojë apo heqë kërkesat e përcaktuara paraprakisht dhe nuk mund të shtojë kërkesa të reja gjatë procesit të vlerësimit.

Prandaj, para se IBM SH.P.K. të eliminohet për mosdorëzimin e mostrave, duhet të ekzistojë dhe të identifikohet kërkesa konkrete mbi bazën e së cilës mostrat duhej të dorëzoheshin.

7.9. IBM SH.P.K. i ka pasur dhe vazhdon t'i ketë produktet në stok dhe të gatshme

Ashtu siç kemi deklaruar edhe në Kërkesën për Rishqyrtim, IBM SH.P.K. **i posedon të gjitha produktet përkatëse në stok dhe të gatshme për paraqitje.**

IBM SH.P.K. ka qenë dhe vazhdon të jetë e gatshme që në çdo ditë pune, në kohën dhe vendin që përcaktohet sipas procedurës, t'i paraqesë produktet për:

- shikim;
- kontroll;
- verifikim;
- krahasim;
- dhe vlerësim teknik.

Nëse në dokumentacionin e tenderit do të ishte përcaktuar qartë se mostrat duhet të dorëzoheshin fizikisht, IBM SH.P.K. do t'i kishte sjellë menjëherë dhe pa asnjë problem, pasi produktet kanë qenë të gatshme.

Këtë nuk e paraqesim si kërkesë për ndryshim apo plotësim material të ofertës pas afatit.

E paraqesim si fakt që dëshmon se mosdorëzimi nuk ka ardhur nga pamundësia teknike, mungesa e produkteve apo refuzimi për bashkëpunim, por nga mungesa e një kërkesë konkrete dhe të qartë për dorëzimin fizik të tyre.

7.10. Edhe një operator tjetër ekonomik është eliminuar për mosdorëzim të mostrave

Nga Njoftimi mbi Vendimin e AK-së rezulton se edhe operatori ekonomik **WOOD CORPORATION L.L.C.** është eliminuar, ndër të tjera, për shkak të mosdorëzimit të mostrave.

Kjo rrethanë është relevante.

Nëse kërkesa ka qenë aq e qartë sa pretendon AK, fakti që më shumë se një operator ekonomik nuk ka dorëzuar mostra e bën të nevojshme që OSHP ta verifikojë me kujdes nëse kërkesa ka qenë vërtet e shkruar dhe e kuptueshme në mënyrë të njëjtë për të gjithë OE-të.

Kjo lidhet drejtpërdrejt me Nenin 7 të LPP-së, i cili kërkon trajtim të barabartë, jo-diskriminues dhe transparent të operatorëve ekonomikë.

7.11. SI E KA DITUR GALANTERIA SH.P.K. SE DUHET TË DORËZOJË MOSTRA DHE KU DUHET T'I DORËZOJË ATO?

Kjo është një nga çështjet kryesore që kërkojmë të verifikohet nga OSHP.

Në Kërkesën tonë për Rishqyrtim të datës 11.08.2026 i kemi kërkuar AK-së sqarime konkrete lidhur me mostrat e operatorit ekonomik **GALANTERIA SH.P.K.**

Në Vendimin e datës 14.08.2026, AK është kufizuar në deklarinë se **GALANTERIA SH.P.K. ka dorëzuar të gjitha mostrat e kërkuara në përputhje me kushtet dhe afatet e përcaktuara në Dosjen e Tenderit.**

Por AK nuk ka treguar:

Cilat janë këto kushte?

Cilat janë këto afate?

Ku janë të shkruara në Dosjen e Tenderit?

Nëse **GALANTERIA SH.P.K.** i ka dorëzuar mostrat, kërkojmë që OSHP të konstatojë:

- 1. Në cilin dokument **GALANTERIA SH.P.K.** e ka parë se mostrat duhet të dorëzohen fizikisht?**
- 2. Në cilën faqe dhe në cilin paragraf të Dosjes së Tenderit është shkruar ky obligim?**
- 3. Si e ka ditur **GALANTERIA SH.P.K.** cilat pozicione duhet t'i sjellë si mostra?**

4. Ku është publikuar lista e pozicioneve që duhet të dorëzohen?
5. Si e ka ditur afatin për dorëzimin e tyre?
6. Si e ka ditur GALANTERIA SH.P.K. vendin ku duhet t'i dorëzojë mostrat?
7. Në cilin dokument është shkruar adresa apo zyra ku duhet të pranohen mostrat?
8. Kush e ka informuar operatorin ekonomik për vendin e dorëzimit?
9. A ka ekzistuar komunikim përmes platformës elektronike, e-mail, njoftim, sqarim apo dokument tjetër?
10. Nëse ka ekzistuar një komunikim i tillë, a u është dërguar i njëjti informacion edhe IBM SH.P.K., WOOD CORPORATION L.L.C. dhe të gjithë operatorëve të tjerë ekonomikë?

Neni 55 i LPP-së përcakton se, me përjashtimet përkatëse, komunikimet dhe këmbimet e informacioneve ndërmjet operatorëve ekonomikë dhe AK-së duhet të bëhen me shkrim.

Prandaj, nëse informacioni se mostrat duhet të dorëzohen dhe vendi ku duhet të dorëzohen **nuk figuron në Dosjen e Tenderit**, por GALANTERIA SH.P.K. e ka marrë këtë informacion nga AK në ndonjë mënyrë tjetër, duhet të ekzistojë prova e komunikimit përkatës.

Dhe nëse ekziston, duhet të verifikohet nëse ky informacion është ofruar në mënyrë të barabartë për të gjithë operatorët ekonomikë.

Në mungesë të një komunikimi të tillë, mbetet pa përgjigje pyetja:

Si ka mundur operatori i rekomanduar për kontratë ta dijë se duhet të sjellë mostra, cilat mostra duhet t'i sjellë dhe ku duhet t'i dorëzojë ato?

Kërkojmë që OSHP të mos mjaftohet me deklarin e përgjithshëm të AK-së, por ta verifikojë këtë fakt në bazë të dokumentacionit.

7.12. KËRKOJMË DOKUMENTACIONIN E PLOTË TË PRANIMIT DHE VLERËSIMIT TË MOSTRAVE TË GALANTERIA SH.P.K.

Nëse mostrat janë dorëzuar, kërkojmë që AK të paraqesë para Ekspertit Shqyrtues dhe OSHP-së:

- a) dokumentin/regjistrin e pranimi të mostrave;
- b) datën e saktë të pranimi;
- c) orën e saktë të pranimi;

- d) vendin/adresën e pranimit;
- e) emrin dhe funksionin e personit që i ka pranuar;
- f) listën e saktë të pozicioneve të dorëzuara si mostra;
- g) procesverbalin e inspektimit;
- h) dokumentacionin e Komisionit që i ka inspektuar;
- i) dëshminë e eliminimit të shenjave identifikuese;
- j) kodimin e mostrave;
- k) raportin teknik të vlerësimit;
- l) çdo fotografi apo dokument tjetër të pranimit dhe vlerësimit;
- m) çdo komunikim të AK-së me GALANTERIA SH.P.K. lidhur me mostrat.

Kjo sepse Neni 37.3 përcakton se mostrat e dorëzuara si kusht duhet të inspektohen nga një komision, ndërsa Neni 37.4 kërkon eliminimin e shenjave identifikuese dhe kodimin e mostrave para vlerësimit.

Nëse AK e ka përdorur mosdorëzimin e mostrave si bazë eliminimi, atëherë duhet të jetë në gjendje të demonstrojë zbatimin e plotë të procedurës për mostrat edhe ndaj operatorit që i ka dorëzuar ato.

7.13. AK KA FUTUR PËR HERË TË PARË ÇËSHTJEN E CERTIFIKATËS TSE-ISO NË VENDIMIN MBI KËRKESËN PËR RISHQYRTIM

Në Vendimin e datës 14.08.2026, Autoriteti Kontraktues ka përfshirë për herë të parë një konstatim lidhur me një certifikatë TSE-ISO dhe ka përmendur mundësinë e veprimeve sipas Nenit 99.2 të LPP-së.

Kjo çështje **nuk ka qenë arsye e eliminimit në B58 të datës 06.08.2026.**

Në vendimin fillestar, arsyeja e vetme e eliminimit ka qenë mosdorëzimi i mostrave.

Rrjedhimisht, kjo çështje nuk ka qenë dhe nuk ka mundur të jetë objekt i Kërkesës për Rishqyrtim të datës 11.08.2026, pasi në momentin e paraqitjes së asaj kërkeje nuk ishte komunikuar si arsye e eliminimit.

IBM SH.P.K. nuk po kërkon që OSHP të injorojë ndonjë çështje për të cilën ligji i jep kompetencë të veçantë.

Pretendimi ynë në këtë ankesë është procedural:

Çështja e certifikatës nuk duhet të përdoret retroaktivisht si arsye e re për të justifikuar ligjshmërinë e vendimit fillestar të eliminimit të datës 06.08.2026, i cili është bazuar vetëm në mostrat.

Vetë Neni 99.2 parashikon një procedurë të veçantë, mbi bazën e një kërkesë me shkrim të AK-së pranë OSHP-së kur AK pretendon paraqitjen e të dhënave të rreme apo dokumentit të falsifikuar.

Prandaj, nëse AK konsideron se ekzistojnë kushtet ligjore për një procedurë të tillë, ajo duhet të trajtohet sipas procedurës së paraparë me ligj dhe mbi bazën e provave përkatëse.

Ajo nuk e ndryshon arsyen konkrete me të cilën IBM SH.P.K. është eliminuar në B58.

7.14. VLERA E OFERTAVE DHE INTERESI EKONOMIK I IBM SH.P.K.

Vlera e parashikuar e aktivitetit të prokurimit është:

38,000.00 €

Oferta e IBM SH.P.K. është:

36,480.00 €

pra:

1,520.00 € nën vlerën e parashikuar.

Oferta e GALANTERIA SH.P.K. është:

41,271.00 €

që është:

3,271.00 € mbi vlerën e parashikuar, ose rreth 8.61% mbi vlerën e parashikuar.

Gjithashtu, oferta e GALANTERIA SH.P.K. është:

4,791.00 € më e lartë se oferta e IBM SH.P.K.

Këto shuma janë paraqitur edhe në Kërkesën tonë për Rishqyrtim.

Ne nuk pretendojmë se tejkalimi i vlerës së parashikuar, në vetvete, e bën automatikisht ofertën të papranueshme.

Megjithatë, kjo rrethanë dëshmon interesin e drejtpërdrejtë ekonomik të IBM SH.P.K. dhe rëndësinë që elimini mi ynë të bëhet vetëm mbi bazën e një kërkesë të qartë dhe të përcaktuar paraprakisht.

Neni 6 i LPP-së kërkon që fondet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike duke marrë parasysh qëllimin dhe objektin e prokurimit.

7.15. KËRKESA PËRFUNDIMTARE

Duke u bazuar në faktet, provat dhe argumentet e paraqitura më lart, konsiderojmë se Vendimi i Autoritetit Kontraktues i datës 14.08.2026 nuk i adreson në mënyrë të plotë dhe konkrete pretendimet tona.

Në veçanti, AK nuk ka treguar:

- ku konkretisht në Dosjen e Tenderit është kërkuar dorëzimi fizik i mostrave;
- cilat pozicione duhet të dorëzoheshin;
- ku duhej të dorëzoheshin;
- si është informuar GALANTERIA SH.P.K. për vendin e dorëzimit;
- dhe ku janë provat e pranimit dhe administrimit të mostrave.

Për këto arsye i propozojmë Organit Shqyrtues të Prokurimit që, pas shqyrtimit të plotë të dokumentacionit dhe administrimit të provave, të marrë:

V E N D I M

I. TË APROVOHET si e bazuar Ankesa e Operatorit Ekonomik IBM SH.P.K.;

II. TË ANULOHET Vendimi i Autoritetit Kontraktues – Komuna e Podujevës, i datës 14.08.2026, me të cilin është refuzuar Kërkesa për Rishqyrtim e IBM SH.P.K.;

III. TË ANULOHET Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues – B58, i datës 06.08.2026, dhe aktiviteti i prokurimit të KTHEHET NË RIVLERËSIM;

IV. TË OBLIGOHET Autoriteti Kontraktues që gjatë rivlerësimit të zbatojë vetëm kërkesat, kriteret dhe kushtet e përcaktuara qartë dhe paraprakisht në Dosjen e Tenderit;

V. TË VERIFIKOHET nga Eksperti Shqyrtues/OSHP se ku konkretisht në Dosjen e Tenderit është kërkuar dorëzimi fizik i mostrave dhe cilat pozicione janë përfshirë;

VI. TË VERIFIKOHET se si operatori GALANTERIA SH.P.K. ka marrë dijeni se mostrat duhet të dorëzohen, cilat mostra duhet të dorëzohen dhe në cilin vend duhet të dorëzohen;

VII. TË OBLIGOHET AK që të paraqesë çdo komunikim, njoftim, sqarim, e-mail apo komunikim në platformë përmes të cilit GALANTERIA SH.P.K. është informuar lidhur me mostrat dhe të verifikohet nëse i njëjti informacion u është ofruar të gjithë operatorëve ekonomikë;

VIII. TË KËRKOHET dokumentacioni i plotë i pranimit, inspektimit, kodimit dhe vlerësimit të mostrave të GALANTERIA SH.P.K.;

IX. Çështja e certifikatës TSE-ISO, e cila nuk ka qenë arsye e eliminimit në B58 të

datës 06.08.2026, TË MOS PËRDORET SI ARSYE E RE RETROAKTIVE për të justifikuar vendimin fillestar të eliminimit, pa paragjykuar kompetencat dhe procedurat tjera të posaçme që parashihen me LPP;

X. TË NDËRMERREN të gjitha masat tjera korrigjuese që OSHP i konsideron të nevojshme për rivendosjen e ligjshmërisë, transparencës dhe trajtimit të barabartë në këtë aktivitet të prokurimit.

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Si pasojë e shkeljeve të lartëcekura dhe eliminimit të IBM SH.P.K. për shkak të mosdorëzimit të mostrave, në rrethana kur kërkesa konkrete për dorëzimin fizik të tyre nuk është përcaktuar në mënyrë të qartë në dokumentacionin e tenderit, kompanisë sonë i është shkaktuar dhe vazhdon t'i kërcënohet shkaktimi i dëmit material.

IBM SH.P.K. ka ofertuar në vlerë prej **36,480.00 €** dhe është privuar nga mundësia që oferta e saj të vazhdojë të shqyrtohet dhe të konkurrojë për dhënien e kontratës.

Ndërkohë, operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë ka ofertuar në vlerë prej **41,271.00 €**, përkatësisht **4,791.00 € më shumë se IBM SH.P.K.**

Dëmet materiale në këtë fazë të procedurës nuk i kemi kalkuluar në mënyrë përfundimtare.

IBM SH.P.K. rezervon të drejtën që dëmet materiale t'i kalkulojë dhe t'i paraqesë në fazat e mëtejshme të procedurës, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

9. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

Bashkëngjitur kësaj Kërkesë për Rishqyrtim paraqiten këto dokumente dhe prova:

Në mbështetje të fakteve dhe pretendimeve të paraqitura në Pikën 7 të kësaj ankese, IBM SH.P.K. bashkëngjit dhe propozon administrimin e dokumenteve dhe provave si në vijim:

- a)** Kopja e Ftesës për Ofertim/Dosjes së Tenderit dhe Aneksit 1 – Specifikimet Teknike;
- b)** Kopja e Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues – B58, datë 06.08.2026;
- c)** Kopja e letrës standarde të eliminimit të IBM SH.P.K., datë 06.08.2026;
- d)** Kopja e letrës standarde për operatorin ekonomik të rekomanduar për kontratë GALANTERIA SH.P.K.;
- e)** Kopja e Procesverbalit të Hapjes së Tenderëve, nëse aplikohet;
- f)** Kopja e Kërkesës për Rishqyrtim të IBM SH.P.K. të datës 11.08.2026;

g) Kopja e Vendimit të Autoritetit Kontraktues mbi Kërkesën për Rishqyrtim, datë 14.08.2026;

h) Dëshmia e pagesës së tarifës së ankesës në OSHP;

i) Çdo dokument dhe korrespondencë tjetër relevante që mbështet pretendimet e paraqitura në këtë Ankesë.